



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:053505
Datë: 11.12.2018
Numri i dokumentit: 00186572



P.nr.212/13

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtarja e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me procesmbajtësen-praktikanten Marigona Shaqiri, në çështjen penale kundër të akuzuarve, [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED], për shkak se në vazhdimësi kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nenpar.1 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore Ferizaj PP.nr.1776/2010 e dt.19.05.2011, dhe PP/II.nr.1347/10 e datës 06.01.2011 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me date 06.11.2018, në praninë e prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, si dhe të akuzuarve [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] në të njëjtën ditë mori dhe me date 09.11.2018 publikisht shpalli, kurse me dt.19.11.2018, përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari, [REDACTED] nga Lipjani rr. e [REDACTED], i lindur me date [REDACTED] në fshatin [REDACTED], komuna e Shtimes, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], shqiptar, shtetas i

Republikës së Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, gjendet në vuajtjen e dënimit në burgun e sigurisë së lartë.

I akuzuari [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], komun Podujeve, i lindur me [REDAKTUAR], në të njëjtin vend nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR], ka të kryer shkollën fillore, i martuar, prind i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, shfrytëzues i pensionit invalidor me aftësi të kufizuara, mban nr. personal [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari [REDAKTUAR], nga Prishtina, lagjja "[REDAKTUAR]", i lindur me [REDAKTUAR], në fshatin [REDAKTUAR], komuna e Podujevës, nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR], ka të kryer shkollën fillore, i martuar, prind i tre fëmijëve, punon taksist, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

1. I akuzuari [REDAKTUAR]

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

- me datë 05.06.2010 rreth orës 11:40 deri në ora 15:20, në rrugën "Gëzim Sahiti" nr [REDAKTUAR] në Ferizaj, përkatësisht në shtëpinë e të dëmtuarit [REDAKTUAR], me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit në bashkëkryerje dy të pandehurit ([REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]) kanë hapur me forcë dritaren e shtëpisë dhe pasi kanë hyrë brenda kanë filluar të kontrollojnë nëpër dhoma të ndryshme dhe kanë marrë stoli të arit në vlerë prej 10.000 euro dhe 2250 euro para të gatshme dhe një laptop të markës "Terra" në vlerë prej 300 euro,
- me datë 24 mars 2010, rreth orës 19:00, në rr. "Bajo Topulli", në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vetë të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në atë mënyrë që në bashkëkryerje me dy të akuzuarit e tjerë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me përdorimin e forcës kanë hapur dritaren e shtëpisë së të dëmtuarit [REDAKTUAR] kanë depërtuar

brenda dhe nga aty kanë marre një laptop, ne vlere prej te pa përcaktuar dhe largohen nga vendi i ngjarjes,

3. me date 03 prill 2010, ne ore te pa caktuar ne rr." E Kukësit", ne Ferizaj, me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete te pasurisë se luajtshme te tjetrit, ne atë mënyrë qe ne bashkëkryerje me përdorimin e forcës kanë hapur dritaren e shtëpisë se te dëmtuarit [REDACTED] kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marre një pale vath ne vlere prej 50 euro dhe dy aparate për matjen e tensionit ne vlere prej 40 euro,
4. me date 11 prill 2010, ne ore te pa caktuar, ne rr." Vëllezërit Gërvalla", ne Ferizaj, me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete te pasurisë se luajtshme te tjetrit, ne atë mënyrë qe ne bashkëkryerje me përdorimin e forcës duke eliminuar pengesat ka hapur derën e podrumit dhe kane depërtuar brenda ne shtëpinë e [REDACTED] dhe nga aty kanë marre një televizor "Plazma", ne vlere prej 2.200 euro, një DVD "Samsung", ne vlere prej 100 euro, nje studio muzikore ne vlere prej 350 euro, sendet e vjedhura i kanë bartur me veturën e te pandehurit [REDACTED] dhe largohen nga aty pa u vërejtur nga askush,
5. me date 22 maj 2010, ne ore te pacaktuar, ne fshatin Muhovc, komuna Ferizaj, me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete te pasurisë se luajtshme te tjetrit, ne atë mënyrë qe ne bashkëkryerje me përdorimin e forcës kanë hapur dritaren e shtëpisë se te dëmtuarit [REDACTED] dhe kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marre dy qafore, një zinxhir qafe dhe një pale vathe ne vlere rreth 850 euro,-

-me të cilën ne vazhdim ka kryer veprën penale Vjedhje e Rëndë nga neni 253 par.1 nen par. 1, te KPK-së.

Ne baze te neneve 3, 5, 6, 11, 15, 34, 35, 36, 38, 64 dhe 65 te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves dhe nenit 365 te KPPK-se e,

G J Y K O N

- Te akuzuarin [REDAKTUAR] me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim duhet te ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.
- Te dëmtuarit: [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ne pajtim me dispozitat nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.
- Konform dispozitave te nenit nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së. Obligohet i akuzuari qe te paguajë paushallin gjyqësor ne shumen prej 30/tridhjete/ euro në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcenim te përmbarimit te dhunshëm.
- Obligohet i akuzuari qe te paguajë shumen prej 30/tridhjete/ eurove ne Fondin për Kompensimin e Viktimave te Krimet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 364 par. 1 nën par. 3 të KPPRK-së

II

LIROHEN NGA AKUZA

Te akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

SEPSE:

1. me date 24 mars 2010, rreth orës 19:00, ne rr."Bajo Topulli", ne Ferizaj, me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete te pasurisë se luajtshme te tjetrit, ne atë mënyrë qe ne bashkëkryerje me te akuzuarin e pare [REDACTED] me përdorimin e forcës kanë hapur dritaren e shtëpisë se te dëmtuarit [REDACTED], kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marre një laptop, ne vlere prej te pa përcaktuar dhe largohen nga vendi i ngjarjes,
2. me date 03 prill 2010, ne ore te pa caktuar ne rr." E Kukesit", ne Ferizaj, me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete te pasurisë se luajtshme te tjetrit, ne atë mënyrë qe ne bashkëkryerje me te akuzuarin [REDACTED] me përdorimin e forcës kanë hapur dritaren e shtëpisë se te dëmtuarit [REDACTED] kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marre një pale vath ne vlere prej 50 euro dhe dy aparate për matjen e tensionit ne vlere prej 40 euro,

I akuzuari [REDACTED]

SEPSE:

3. me date 11 prill 2010, ne ore te pa caktuar, ne Rr." Vëllezërit Gërvalla", ne Ferizaj, me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete te pasurisë se luajtshme te tjetrit, ne atë mënyrë qe ne bashkëkryerje me te akuzuarin [REDACTED] dhe [REDACTED] me përdorimin e forcës duke eliminuar pengesat kanë hapur derën e podrumit dhe kane depërtuar brenda ne shtëpinë e [REDACTED] dhe nga aty kanë marre një televizor "Plazma", ne vlere prej 2.200 euro, një DVD "Samsung", ne vlere prej 100 euro, një studio muzikore ne vlere prej 350 euro, sendet e vjedhura i ka bartur me veturën e te pandehurit [REDACTED] dhe largohen nga aty pa u vërejtur nga askush,
4. me date 22 maj 2010, ne ore te pacaktuar, ne fshatin Muhovc, komuna Ferizaj, me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete te pasurisë se luajtshme te tjetrit, ne atë mënyrë qe ne bashkëkryerje me te akuzuarin [REDACTED] dhe [REDACTED] me përdorimin e forcës kanë hapur dritaren e shtëpisë se te dëmtuarit [REDACTED] dhe kanë depërtuar

brenda dhe nga aty kanë marre dy qafore, një zinxhir qafe dhe një pale vathe ne vlere rreth 850 euro,-

- meqë nuk eshte provuar se ne bashkëkryerje dhe ne vazhdimësi kane kryer veprën penale per te cilën janë akuzuar nga ana e prokurorisë.
- Shpenzimet e procedurës penale bien mbi barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës.

Në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par 1.1 të KPPK-ës,

III

REFUZOHET AKUZA

Për te akuzuarin [REDAKTUAR]:

SEPSE:

me date 05.06.2010 rreth orës 11:40 deri ne ora 15:20, ne rrugën “Gëzim Sahiti” nr. [REDAKTUAR], ne Ferizaj, përkatësisht ne shtëpinë e te dëmtuarit [REDAKTUAR], me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm te pasurisë se luajtshme te tjetrit se bashku me te akuzuarin [REDAKTUAR] kanë hapur me force dritaren e shtëpisë dhe pasi kanë hyre brenda kanë filluar te kontrollojnë neper dhoma te ndryshme dhe kanë marre stoli te arit ne vlere prej 10.000 euro dhe 2250 euro para te gatshme dhe një laptop te markës “Terra” ne vlere prej 300 euro,

me date 11 prill 2010, ne orc te pa caktuar, ne Rr.” Vëllezërit Gërvalla”, ne Ferizaj, me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete te pasurisë se luajtshme te tjetrit, ne atë menyre qe ne bashkëkryerje me te akuzuarin [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me përdorimin e forcës duke eliminuar pengesat kanë hapur derën e podrumit dhe kane depërtuar brenda ne shtëpinë e [REDAKTUAR] dhe nga aty kanë marre një televizor “Plazma”, ne vlere prej 2.200 euro, një DVD “Samsung”, ne vlere prej 100 euro, një studio muzikore ne vlere prej

350 euro, sendet e vjedhura i ka bartur me veturën e te pandehurit [REDAKTUAR] dhe largohen nga aty pa u vërejtur nga askush,

me date 22 maj 2010, ne ore te pacaktuar, ne fshatin Muhovc, komuna Ferizaj, me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete te pasurisë se luajtshme te tjetrit, ne atë mënyrë qe ne bashkëkryerje me te akuzuarit e tjerë me përdorimin e forcës kanë hapur dritaren e shtëpisë se te dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe kanë depërtuar brenda dhe nga aty kanë marre dy qafore, një zinxhir qafe dhe një pale vathe ne vlere rreth 850 euro,-

me te cilën do te kryente veprën penale ne vazhdim “vjedhje e rende” ne bashkëkryerje nga neni 253 par.1 nenpar.1 lidhur me nenin 23 te KPK-se.

- meqë prokurori i shtetit, në shqyrtimin gjyqësor është tërhequr nga akuza, për veprën penale “vjedhje e rende” ne bashkëkryerje nga neni 253 par.1 nenpar.1 lidhur me nenin 23 te KPK-se.
- Shpenzimet e procedurës penale bien mbi barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore ne Ferizaj me aktakuzat PP.nr.1776/2010 e dt.19.05.2011, dhe PP/II.nr.1347/10 e datës 06.01.2011. ka akuzuar [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] se ne vazhdimësi kane kryer veprën penale Vjedhje Rende nga neni 253 par.1, nenpar.1 lidhur me nenin 23 te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves.

Gjykata duke vepruar ne pajtim me nenin 245 te KPPRK-se ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 17.09.2018 dhe 17.10.2018, dhe shqyrtimin gjyqësor me datën 06.11.2018. Gjykata pasi ka vërejtur se për veprat penale janë akuzuar te njëjtit persona si dhe pasi ka vërejtur se veprat penale kane lidhshmëri me njëra-tjetrën, ne kuptim te nenit 35.par.1 i KPPRK-se per shkak te ekonomizimit dhe efikasitetit te procedure gjykata vendosi për

bashkimin e lendeve me numër P.nr.1654/13 dhe P.nr.212/13 për veprat penale si dhe për akuzat e larte cekura, ku ne te ardhmen do te udhëhiqen me numrin me te vogël **P.nr.212/13**.

Ne hapjen e shqyrtimit gjyqësor gjyqtarja udhëzoi te akuzuarit ne kuptim te nenit 246 par.1 i KPPK-se, dhe çmoi se te drejtat e te akuzuarve janë respektuar. Me pas Prokurori u ka lexuar te akuzuarve aktakuzën dhe pasi qe gjykata është bindur se te njëjtit e kanë kuptuar ne tërësi aktakuzën me te cilën janë akuzuar, te njëjtit i ka ofruar te drejtën te deklarohen lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tyre për veprën penale për te cilën janë ngarkuar nga ana e prokurorisë.

I akuzuari [REDACTED] ne shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprat penale për te cilat është akuzuar nga ish Prokuroria Publike Komunale e Ferizajt dhe ka shtuar se natën kritike kur janë kryer këto vjedhje te akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] nuk kanë qene me te duke theksuar se me pare e ka pranuar këtë fakt me arsyetimin se ka qene i maltretuar nga ana e policeve ne Ferizaj, mirëpo gjyqtarja e vetme gjykuese nuk ia ka pranuar fajësinë me arsyetimin se pasi qe i akuzuari [REDACTED] akuzohet se veprat penale i ka kryer ne bashkëkryerje me dy te akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] është ne interes te procedurës për te vërtetuar gjendjen faktike te këtyre dy rasteve penale dhe një vendim te tille e ka mbështetur edhe prokurori i shtetit.

I akuzuari [REDACTED] me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tij për veprat penale për te cilat është akuzuar ka deklaruar se: *“se nuk është fajtor për këto vepra penale, duke shtuar se është e vërtete se ne ish Prokurorinë Publike ne Ferizaj kishte dhënë një deklaratë për një vepër te vitit 2007, ndërsa sa i përket këtyre rasteve për te cilat akuzohem nuk e ndiej veten fajtor pasi qe un nuk i ka kryer këto vepra penale. Po ashtu i akuzuari ka përmendur edhe faktin se deklarata e dhënë ne stacionin policor është marre ne pyetje pa prezencën e avokatit për te cilën ka qene e domosdoshme prezenca e tij.*

I akuzuari [REDACTED] ne deklarimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprat penale për te cilat është akuzuar ka deklaruar se *nuk e ndien veten fajtor për këto vepra penale për te cilat është ngarkuar me aktakuze duke theksuar se ai nuk i ka kryer këto vepra penale.*

Prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara si dhe nga vete pranimi i fajësisë se te akuzuarit [REDACTED] është vërtetuar se gjendja faktike si ne

dispozitivat e aktakuzave se i pandehuri ka kryer veprën penale për te cilën është ngarkuar dhe atë ne vazhdimësi dhe ne bashkëkryerje sepse edhe nga seancat e sotme i akuzuari [REDACTED] ka deklaruar se e pranon fajësinë sa i përket dy aktakuzave ashtu sic është përshkruar ne dispozitivat e rikualifikimit te juridik te këtyre veprave penale. Po ashtu Prokurori ne fjalën përfundimtare ka shtuar se i akuzuari [REDACTED] dhe [REDACTED] e kane mohuar kryerjen e veprave penale për te cilat janë akuzuar, mirëpo nga provat e administruara sidomos ne hetuesi vërtetohet e kundërta e saj me vete faktin se i akuzuari [REDACTED] ne deklarimet e tij e ka pohuar se vjedhjet i ka kryer me dy te akuzuarit e tjerë edhe pse këtë e mohon ne shqyrtimin gjyqësor me arsyetimin se ka qene i detyruar dhe atë deklarate e ka dhënë nen trysnin e zyrtareve policor. Me tutje prokurori ka theksuar se gjendja si ne dispozitiv te këtyre aktakuzave është vërtetuar edhe nga deklaratat e te dëmtuarve [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe i ka propozuar gjykatës qe te akuzuarit t'i shpalle fajtor dhe tu shqiptoje sanksion penal ne pajtim me ligjin.

I akuzuari [REDACTED] ne fjalën përfundimtare ka deklarua se e pranon fajësinë për këto vepra penale, është i penduar thelle dhe shpreh keqardhje, është penduar dhe u ka kërkuar falje publike te dëmtuarve si dhe i premtoj gjykatës qe pas vuajtjes se dënimit nuk do te përsërisë vepra te tjera penale, do t'i kthehet jetës normale prandaj i ka propozuar gjykatës qe te merr parasysh këto rrethana dhe t'i shqiptoje një dënim sa me te bute.

I akuzuari [REDACTED] ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se është i pafajshëm për këto vepra penale, se ne atë periudhe kohore për te cilën është akuzuar ka qene ne vuajtje te dënimit prej muajit prill deri ne muajin korrik te vitit 2010 dhe se për këtë i ka paraqitur dëshmi gjykatës duke shtuar se ne deklaratën e dhënë ne polici e ka pranuar kryerjen e këtyre veprave për shkak se ka qene i maltretuar dhe ka pësuar dëme te boshtit kurrizor dhe për këtë posedon edhe dëshmi.

I akuzuari [REDACTED] ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se është i pafajshëm për këto vepra penale për te cilat është akuzuar, se e kundërshton fjalën përfundimtare te prokurorit te shtetit dhe ka kërkuar nga gjykata qe te sjelle aktgjykim lirues.

Pasi që te akuzuarit, nuk e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, si dhe në shqyrtimin gjyqësor për asnjë pikë të dispozitivit të këtij aktgjykimi për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 lidhur me nenin 23 te KPK-se (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosoves),

gjykata me qellim te vërtetimit te drejte dhe te plote te gjendjes faktike ka shqyrtuar dhe administruar secilën prove vec e vec dhe te ndërlidhura ne mes vete.

Gjykata gjendjen faktike si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi e ka vërtetuar ne baze te provave te paraqitura ne shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- nga dëshmia e te akuzuarit [REDACTED] e dhënë ne shqyrtimin gjyqësor
- nga mbrojtja e të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED]
- nga leximi deklaratave e të dëmtuarve [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED]
- deklaratat e te akuzuarve dhënë ne polici si dhe
- nga shikimi i shkresave te tjera te lendes.

I akuzuari [REDACTED] ne deklarimin e tij ne shqyrtimin gjyqësor ka theksuar se me [REDACTED] njihen mes vete pasi qe është baxhanaku i dajës se tij [REDACTED], ndërsa me [REDACTED] ka deklaruar se nuk njihen, por vetëm janë takuar ndonjëherë, po ashtu i akuzuari ka deklaruar se e kundërshton ne tërësi deklaratën e dhënë ne polici pasi qe nuk është e vërtetë se veprat për te cilat është akuzuar i ka kryer ne bashkëkryerje me dy te akuzuarit tjerë, duke deklaruar se ne polici ka deklaruar rrejshëm me arsyetimin se gjate marrjes se deklaratës ndaj tij është ushtruar dhune nga ana e zyrtareve policor dhe se gjate marrjes se deklaratës nuk ka qene prezent avokati. I akuzuari ka potencuar edhe faktin se nuk është njoftuar nga ana e zyrtareve policor për te drejtat e tij gjate marrjes ne pyetje dhe se procesverbalin e ka nënshkruar pa e lexuar fare. Ndërkaq kur prokurori e ka ballafaquar me faktin se ne procesverbalin e marrjes ne pyetje ne polici thuhet se pasi i janë lexuar te drejtat te akuzuarit është nënshkruar procesverbali, i akuzuari e ka mohuar këtë me pretendimin se nuk i është lexuar procesverbali, por vetëm i është thënë qe ta nënshkruaje. Edhe ne këtë rast i akuzuari ka theksuar se me përgjegjësi te plote deklaroj se nuk ka kryer asnjë vepër penale se bashku me këta dy persona.

I akuzuari [REDAKTUAR] ne deklarimin e tij ne shqyrtimin gjyqësor ka theksuar se ne organet policor është paraqitur vullnetarisht pasi qe është njoftuar nga ana e vëllait te tij [REDAKTUAR] se është duke u kërkuar nga ana e policisë dhe se me sa i kujtohet ai ka dhënë deklarate për një vepër te cilën e ka kryer ne vitin 2007 ku ka qene i ngarkuar për thyerjen e një lokali. Mirëpo kur prokurori e ka ballafaquar me një deklarate te dhënë ne ish Prokurorinë Publike me date 26.09.2011 ku ne rreshtin e gjashte te saj thuhej se “ *me rastin e marrjes ne pyetje ne stacionin policor ne Ferizaj me datën 25.09.2010...*”, i akuzuari ka deklaruar se për asnjërin deklarate nuk ka te beje me këto vepra penale, duke potencuar faktin se ne Prokurorin Publike Komunale ka dhënë deklarate vetëm për një vepër penale te vjedhjes qe e ka kryer ne vitin 2007 e jo ne vitin 2010. Po ashtu i akuzuari ka deklaruar se edhe atëherë e ka njoftuar ish Prokurorinë Publike se për veprën për te cilën është akuzuar ka gjate asaj kohe ka qene ne vuajtjen e dënimit, por qe prokurori i çështjes nuk e ka marr parasysht.

I akuzuari [REDAKTUAR] ne deklarimin e tij ne shqyrtimin gjyqësor ka theksuar se qëndron pranë deklaratës se dhënë ne polici me datën 18.09.2010, e ka mohuar te ketë pasur veture “Golf 2” me ngjyre te kuqe dhe se ne vitin 2007/2008 ka qene i përfshirë ne një vjedhje dhe se prej asaj kohe me nuk është shoqëruar me [REDAKTUAR] Me tutje i akuzuari ka deklaruar se nuk është ne dijeni se ku gjendet rruga “ E Kukësit”, “ Vëllezërit Gërvalla” dhe fshati Muhovc.

Vlerësimi i Provave

Sa i përket dispozitivit te pare te këtij aktgjykimi pra pjesës dënuese-i akuzuari [REDAKTUAR] Hysenaj ne shqyrtimin gjyqësor si ne fjalën hyrëse edhe ne fjalën përfundimtare e ka pranuar fajësinë për veprat penale për te cilat është akuzuar, duke shprehur keqardhje për veprat e kryera, po ashtu edhe për të dëmtuarit, për të dëmtuarit si dhe faktin se i akuzuari i ka premtuar gjykatës se pas vuajtjes se dënimit do ti kthehet jetës normale dhe nuk do te përsërisë me vepra te tjera penale,

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPR-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit si:

kallëzimi penal me nr.2010-CF-1138 i datës 08.12.2010, procesverbali mbi marrjen ne pyetje me autorizim te te akuzuarit [REDACTED] i datës 12.09.2010, kallëzimi penal me nr. 2010-CF-0561, 2010-CF-0660 i datës 06.10.2010, si dhe ne te gjitha shkresat dhe dosjet e lendes.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje Rende nga neni 253 par.1, nenpar.1 lidhur me nenin 23 te Kodit te përkohshëm Penal te Kosoves. ashtu sic është theksuar ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, te përshkruar ne datën, vendin, kohen dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për te akuzuarin [REDACTED] gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 64 dhe 65 të KPK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, duke shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale te kryer, kalimi i kohës nga kryerja e veprave penale rreth tete vite, ndërsa si rrethane renduese gjykata gjeti faktin se i akuzuari është recidivist (përsëritës i veprave penale faktin se i akuzuari është duke vuajtur dënimin ne Burgun e Sigurisë se Larte për veprën penale te vrasjes me dënim 25/njëzet e pesë vjet.

Andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Sa i përket pjesës se dyte-pjesës liruese - gjykata me një vëmendje te posaçme ka vlerësuar dhe analizuar edhe deklaratat e te akuzuarve dhënë ne shqyrtimin gjyqësor, deklaratat e te dëmtuarve dhënë ne polici si dhe procesverbalet e marrjes ne pyetje te te akuzuarve nga ana e policisë si dhe te gjitha shkresat e tjera qe i janë bashkangjitur dosjes se lendes dhe pas vlerësimit me kujdes te secilës prove vec e vec dhe te ndërlidhura ne mes vete ne kuptim te nenit 257 te KPPRK-se, gjykata konstatoi se me asnjë prove konkrete nuk është vërtetuar ne mënyrë bindëse dhe te pakontestueshme se te akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] kane kryer veprën penale për te cilën janë akuzuar ne baze te aktakuzës se Prokurorisë Themelore andaj ka vendosur qe te njëjtit t'i liroje nga akuza.

Dëshminë - deklaratën e te akuzuarit [REDAKTUAR] te dhënë ne shqyrtimin gjyqësor gjykata e konsideroi si pjesërisht te besueshme, përkatësisht deklaratës se te akuzuarit se dy te akuzuarit e tjerë nuk kane qene te pranishëm me te me rastin e kryerjes se këtyre veprave penale, gjykata i shprehi besimin e plote ngase e kundërta e saj nuk mund te vërtetohej me asnjë prove konkrete, por gjykata nuk i shpreh besimin deklaratës se këtij dëshmitari se për shkak te presionit te ushtruar ndaj tij me rastin e marrjes se deklaratës nga ana e policisë ai kishte deklaruar se se bashku me te kane qene edhe dy te akuzuarit tjerë ngase këtë pjese te deklaratës gjykata e konsideroi si jo reale dhe jo te besueshme dhe te njëjtës nuk i shprehi besimin e plote.

Po ashtu gjykata me një vëmendje te posaçme ka vlerësuar edhe deklaratat e dhëna nga te dëmtuarit ne polici, por me kete rast gjykata pas vlerësimit te këtyre deklaratave gjeti se te njëjtat përveç qe provonin se vepra penale kishte ndodhur me asnjërin prej tyre nuk mund te dëshmohej ne mënyrë bindëse dhe te pakontestueshme se te akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] e kishin kryer veprën penale për te cilën janë akuzuar, ngase asnjeri prej te dëmtuarve ne deklaratat e tyre nuk kishte deklaruar se i kishte pare te akuzuarit ne vendngjarje dhe nuk mund t'i identifikonin te njëjtit si kryerës te këtyre veprave penale.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë "*in peius*" ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë "*in favorem*" ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohej si e kundërt dhe në këtë mënyrë

lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërës prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Andaj Gjykata bazuar në provat e prezantuara për këtë pjesë të aktgjykimit ka konstatuar se nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë.

Andaj nisur nga këto që u cekën, Gjykata të akuzuarin e liroi nga akuza për veprën penale për të cilën akuzohet me akuzën e prokurorit të shtetit.

Sa i përket diapozitivit III të këtij aktgjykimi- pjesës refuzuese- pasi që prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor ka theksuar se tërhiqet nga ndjekja penale për të akuzuarin [REDAKTUAR] për veprën penale sipas aktakuzës PP/II.nr.1776/2010 dhe për diapozitivat 3 dhe 4 të aktakuzës PP/II.nr. 1347/2010 sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor është paraqitur flete lëshimi nga Qendra e Paraburgimit në Lipjan i datës 11.07.2010 e nga i cili flete lëshim vërtetohet se i pandehuri [REDAKTUAR] nga data 07.04.2010 e deri me datë 12.07.2010 me aktvendim të Gjykatës së atëhershme Komonale P.nr.89/2-2010 të datës 08.04.2010, me të cilin aktvendim e ka mbajtur paraburgimin në datat e lartë përmendura, andaj i propozoi gjykatës se për aktakuzën e lartpërmendur dhe për diapozitivat 3 dhe 4 të aktakuzës PP/II.nr.1347/2010 mos të administrohen fare provat pasi që konsideron se i pandehuri nuk i ka kryer këto vepra penale dhe duke u bazuar në flete lëshimin e Qendrës së Paraburgimit në Lipjan heqim dorë nga ndjekja penale për aktakuzën dhe dispozitivat 3 dhe 4 që janë përmendur me lart dhe ka kërkuar që procedura të vazhdojë për pjesën tjetër të aktakuzës.

Pasi që Prokurori i Shtetit ka hequr dorë nga ndjekja penale për veprën penale sipas aktakuzës PP.II.nr 1776/2010 dhe sipas diapozitivave 3 dhe 4 të aktakuzës PP/II.nr. 1347/2010 , gjykata duke u bazuar në nenin 363 par.1 pika 1.1 të KPPK-së vendosi që të akuzuarin [REDAKTUAR] ta lirojë nga përgjegjësia penale për veprat penale për të cilat prokurori ka hequr dorë nga ndjekja penale ashtu sic është theksuar edhe në dispozitivin III të këtij aktgjykimi.

Gjykata pasi vërejtë se vepra penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit sipas aktakuzës PP.II.nr 1776/2010 dhe PP/II.nr. 1347/2010 janë kryer në vitin 2010 dhe duke pasur parasysh se në atë kohë ka qenë në fuqi Kodi i përkohshëm Penal i Kosovës, duke u bazuar në nenin 3 par. 1 dhe 2 të Kodit aktual Penal të Kosovës e i cili i referohet zbatimit të ligjit me të

favorshëm për te pandehurin gjykata me rastin e gjykit të kësaj veprë penale aplikoi dispozitat e Kodit të përkohshëm Penal të Kosovës të vitit 2004.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë për dispozitivin e I-re është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë për dispozitivin e II-te dhe III-te është marr në kuptim të dispozitës së nenit 454 par.1 të KPPRK-se.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal,

P.nr.212/13 datë 19.11.2018

Procesmbajtësja

Marigona Shaqiri

Gjyqtarja,

Hakile Ilazi



KËSHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit me shkrim të kopjes se këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes Gjykatës Themelore në Ferizaj.